REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5076 Prot. Maliq, më 25.08.2026

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 2, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e henë, **më datë 31.08.2026, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:(Paraprak)

1.Hapja e mbledhjes (kuorumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë (24.07.2026)
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin korrik 2026";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për famije z.Ll.Saro banues në fshatin Rrëmbec Njësia Administrative Pojan, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies të zjarrit ";
6.P-V "Për një rishpërndarje në buxhetin e bashkisë Maliq për vitin 2026";
7.P-V Për miratimin e rregullores *"Për administrimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në territorin e bashkisë Maliq";*
8.Diskutime të tjera.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e premte me datë 28.08.2026 nga ora 10:00-13:00 si më poshtë:

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut. Pika 4 e rendit të ditës:z.Faslli Zholli, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari

Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit. Pika 5 e rendit të ditës: z.Dritan Çami, z.Ilia Xhuti, znj.Floreta Zaçe, z.Faslli Zholi, z.Yllson Ibrahimllari

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pika 6 e rendit të ditës:
z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Marianthi Avrami, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit. Pika 7 e rendit të ditës: z.Idlir Limllari, znj.Pranvera Begolli, z.Almir Elezi, z.Faslli Zholi, z.Selami Muço.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

